



REPUBLIKA E SHOIPËRISE
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

RAPORTI VJETOR 2025

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....

II. RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE.....

2.1 Niveli i Sigurisë në vend sipas veprave penale kryesore

- 2.1.1 Krimet kundër personit.....
- 2.1.2 Dhuna në familje.....
- 2.1.3 Trafiket e paligjshme.....
- 2.1.4 Krimet ndaj pronës dhe pasurisë.....
- 2.1.5 Krimi kibernetik.....
- 2.1.6 Siguria rrugore.....
- 2.1.7 Vepra penale në fushën e terrorizmit.....

2.2 Lufta Kundër Krimin të Organizuar

- 2.2.1 Hetimet proaktive.....
- 2.2.2 Operacione policore kundër krimin të organizuar.....
- 2.2.3 Grupe kriminale të goditura dhe vepra penale të referuara për grupet kriminale.....
- 2.2.4 Asete të sekuestruara nga veprimtaritë kriminale.....
- 2.2.5 Kultivimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike.....
- 2.2.6 Korrupsioni.....

2.3 Menaxhimi i Integruar i Kufirit dhe Migracionit

- 2.3.1 Hyrje –daljet në kufi.....
- 2.3.2 Shtetas në kërkim të kapur në kufi.....
- 2.3.3 Kalim i paligjshëm i kufirit.....
- 2.3.4 Imigrantë në Republikën e Shqipërisë.....
- 2.3.5 Menaxhimi dhe trajtimi i të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe trajtimi i kërkesave për vizë.....

2.4 Forcimi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional dhe Ndërkombëtar.....

III. AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

- 3.1 Veprimtaria rregullatore dhe normative.....
- 3.2 Bashkëpunime rajonale dhe trajnime
- 3.3 Agjencia Digjitale.....
- 3.4 Hetimeve Proaktive dhe Hetimeve Procedurale Penale.....
- 3.5 Hetimi Administrativ i Ankesave & Inspektimit.....
- 3.6 Procesi i Vlerësimit Kalimtar (Vettingu).....
- 3.7 Mbikëqyrja nëpërmjet CSP/Pastërtisë së Figurës.....

IV GARDA E REPUBLIKËS

- 4.1 Ndryshimet dhe përmirësimi i kuadrit ligjor.....
- 4.2 Samiti i gjashtë i Komunitetit Politik Evropian (KPE) dhe Ministeriali i Procesit të Bashkëpunimit

në Evropën Juglindore (SEECp).....	
4.3 Aktivitete të tjera të rëndësishme gjatë vitit 2025.....	
4.4 Trajnime, kurse dhe kualifikime.....	
V. INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT	
5.1 Vendime dhe inspektime nga IKMT për vitin 2025.....	
5.2 Zbatimi i projekteve madhore.....	
5.3 Bashkëpunimi me IMT-të e bashkive dhe mbrojtja e parqeve me rëndësi kombëtare ...	
5.4 Mbrojtja e vijës bregdetare.....	
5.5 Ankesa dhe Platforma e Bashkëqeverisjes.....	
VI. QENDRA E KOORDINIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM	
6.1 Fuqizimi i Komiteteve Rajonale dhe realizimi i trajnimebe për strukturat ligjzbatuese	
6.2 Edukimi dhe ndërgjegjësimi në komunitet.....	
6.3 Fuqizimi i Komiteteve fetare dhe i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike...	
6.4 Procesi i Rehabilitimit/ Riintegritimit/ Risocializimit për personat e kthyer nga zonat e konfliktit Siri/Irak (RRR).....	
VII. QENDRA PRITËSE PËR AZILKËRKUESIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	
7.1 Azilkërkues të akomoduar.....	
7.2 Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse.....	
7.3 Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2025	
7.4 Prioritetet dhe objektivat për vitin 2026.....	
VIII. SHTËPIA E PUSHIMIT.....	
IX. MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI	
9.1 Praktikat dhe procedurat e ndjekura për vitin 2025.....	
9.2 Zjarre, inspektime dhe ndërhyrje shpëtimi	
9.3 Bashkëpunime projekte dhe aktivitete të realizuara përgjatë vitit 2025	
9.4 Trajnime të punonjësve sipas Plan-Kalentarit 2025	

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ministria e Punëve të Brendshme gjatë vitit 2025, ka marrë një sërë masash për zbatimin e prioritetëve dhe objektivave me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, mbrojtjes së territorit, ruajtjes së integritetit të punonjësve të policisë, si dhe garantimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjatë vitit 2025 Ministria e Punëve të Brendshme ka nënshkruar marrëveshjen për projektin “*Smart City*”, projekt i cili do të implementohet në 20 qytetet më të mëdha, në nyjet e akset rrugore kombëtare më të rëndësishme, në sheshe e zona me qarkullim të dendur, përfshirë edhe shkollat. Në vijim të këtij projekti me rëndësi kombëtare, u ngrit edhe Qendra Kombëtare e Monitorimit të Trafikut, me 122 operatorë.

Një ndër arritjet më të mëdha që përfaqëson një hap konkret në përmbushje të standardeve evropiane është hapja e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ARO), një strukturë kjo, që do të forcojë kapacitetet institucionale në luftën kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit.

Antarësimi i Shqipërisë në Drejtorinë e Çelësave Publike, si *vpg.* 3endi i 99-të, i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), ishte një tjetër arritje duke garantuar verifikim të sigurt dhe të standardizuar të pasaportave biometrike shqiptare në të gjitha shtetet pjesëtare të ICAO PKD. Gjithashtu gjatë vitit 2025 u prezantua një tjetër projekt strategjik “Identiteti Digjital”, si hap drejt modernizimit teknologjik e përafrimit me standardet evropiane në shërbimet publike.

Për herë të parë u prodhua lista zgjedhore për votuesit jashtë vendit, ku u regjistruan 175,648 votues. Nga ana tjetër prodhimi i Letërnjoftimeve Elektronike (ID karta) u përshpejtua përmes një pagesë shtesë dhe brenda një afati kohor 3-ditor me kupona, që tashme blihen online. Gjithashtu, me qëllim pajisjen e shtetasve shqiptarë me dokumente biometrikë jashtë vendit, në Zyrat e Aplikimit të Përfaqësive të Republikës së Shqipërisë, u nënshkrua marrëveshje mes MPB, MEPJ dhe IDentiTek.

Me qëllim forcimin e kontrollit mbi territorin, janë miratuar masa ligjore shtesë, për ndëshkimin e veprimtarisë së paligjshme, duke u shtrirë operacionet edhe në zonat turistike.

Përgjatë vitit 2025, Ministria e Punëve të Brendshme ka përmirësuar kuadrin ligjor, duke sjellë rritjen e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit zjarrfikës dhe aparatit të minsitrisë.

Garantimi i sigurisë për mbarëvajtjen e Samitit e Komunitetit Politik European, mbajtur për herë të parë në Tiranë duke mbledhur liderët më të rëndësishëm të BE-së, si dhe aktiviteti “Giro d’Italia 2025, evente me peshë specifike në arenën ndërkombëtare, ishin një tjetër arritje që Ministria e Punëve të

II. RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

2.1 Niveli i sigurisë në vend sipas veprave penale kryesore

Gjatë vitit 2025, Policia e Shtetit ka realizuar misionin e saj institucional nëpërmjet organizimit dhe kontrollit të veprimtarisë së strukturave të sigurisë publike, me qëllim zbatimin e legjislacionit për ruajtjen e rendit publik dhe mbrojtjen e jetës.


Në këtë kuadër, është garantuar respektimi i të drejtave të individit, si dhe është forcuar puna për parandalimin, zbulimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale. Njëkohësisht, është siguruar mbrojtja fizike e institucioneve dhe e pronave më të rëndësishme publike dhe private, është rritur siguria rrugore dhe është siguruar ndërhyrje në kohë dhe me efikasitet në rast situatash apo ngjarjesh kriminale.

Gjithashtu, gjatë këtij viti është punuar për përgatitjen dhe përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me fushën e rendit publik, në funksion të rritjes së standardeve dhe efektivitetit të veprimtarisë policore.

Disa nga detyrat / aktivitetet e rëndësishme masive të përfunduara me sukses:

- ✓ Sigurimi i rendit publik, para, gjatë dhe pas zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në datë 11.05.2025.
- ✓ Sigurimi i mbarëvajtjes së aktivitetit sportiv Giro d'Italia në vendin tonë.
- ✓ Sigurimi i Samitit të Komunitetit Politik Evropian në Tiranë, më 16.05.2025.
- ✓ Sigurimi i rendit publik gjatë sezonit turistik veror 2025.
- ✓ Sigurimi i rendit gjatë aktiviteteve sportive në ndeshjet kombëtare e ndërkombëtare,
- ✓ Garantimi i zhvillimit normal të procesit mësimor nëpërmjet zbatimit të masave të përcaktuara në paketën e sigurisë në shkolla.
- ✓ Harmonizimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, eksplozivëve dhe fishekzjarrëve në harmoni me kuadrin rregullator të BE-së.

Gjatë vitit 2025, janë evidentuar **38345 vepra penale**, nga të cilat janë zbuluar autorët për 36350 ose **94.8%** e tyre. Krahësuar me vitin 2024, u evidentuan rreth **17.4%** vepra penale më shumë. Numri i vrasjeve me dashje, është ulur me **2.4%**; vrasjet nga pakujdesia janë ulur **40%**, vrasjet e mbetura në tentativë janë ulur me **4.8%**, rritur veprat penale kundër shëndetit me **12%** dhe i vjedhjeve me armë me 0%, ndërsa zbulimi i tyre është 100%; numri i vjedhjeve të bankave është ulur me **50%**.



Numri i personave të dëmtuar nga veprat penale këtë vit rezulton të jetë **19,142** nga të cilët, 1409 persona të grupmoshës deri 18 vjeç ose 7.3%. me pasojë vdekjen janë 340 ose 1.7%. Nga totali i të dëmtuarve **5,646** janë të gjinisë femërore dhe **13,496** të gjinisë mashkullore.


Numri i autorëve të implikuar në këto aktivitete kriminale është 39028 autorë, prej të cilëve janë arrestuar në kushtet e flagrancës 6925, janë ndaluar 1096 autorë, 29043 ndiqen në gjendje të lirë dhe 1930 janë larguar. Nga totali i autorëve të përfshirë në aktivitete kriminale, **93.3%** janë të gjinisë femërore dhe **6.7%** të gjinisë mashkullore.

2.2.1 Krimet kundër personit


Evidentuar gjithsej **4755 vepra penale kundër personit**, nga të cilat janë **zbuluar 4641** ose **96.25% e tyre**. Në krahasim me vitin e mëparshëm kanë ndodhur **871 vepra penale më shumë**.

Gjatë vitit 2024, janë regjistruar **40** vrasje me dashje, nga të cilat **31** janë zbuluar, duke shënuar një rënie me 1 vrasje krahasuar me vitin 2024. Po ashtu, janë regjistruar 3 vrasje nga pakujdesia, 2 më pak se viti i kaluar. Sa i përket tentativave për vrasje, janë evidentuar **79** raste, nga të cilat **76** janë zbuluar, një rënie prej **4.8%** e rasteve krahasuar me vitin 2024.

Vrasje me dashje



Tendenca e kriminalitetit sipas qarqeve: Qarku i Tiranës është qarku në të cilin kanë ndodhur pjesa më e madhe e veprave penale edhe për vitin 2025, ndërsa Qarku i Gjirokastrës është qarku me numrin më të vogël të veprave penale të evidentuara gjatë vitit 2025 duke shënuar dhe një rënie me 1.6% të veprave penale, krahasuar me vitin e kaluar.




Powered by Bing
© OpenStreetMap

2.1.2 Dhuna në familje

Janë referuar materialet në prokurori për veprën penale “*Dhunë në Familje*”, bazuar në nenin 130/a, për 2325 raste të dhunës në familje, 186 raste më shumë, ose 8% më shumë se gjatë vitit 2024, ku janë referuar 2139 raste. Janë trajtuar me kërkesë-padi “*Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/Urdhrit të Mbrojtjes*”, 2,849 raste të dhunës në familje duke shënuar rënie me 3% në raport me vitin 2024 ose 85 raste më pak të trajtuara me kërkesë-padi.


Dhuna në familje, neni 130/a



2.1.3 Trafiket e paligjshme

Numri i trafikeve të paligjshme gjatë vitit 2025 ka shënuar rritje me 143 vepra penale krahasuar me vitin e kaluar. Janë evidentuar në total **1, 307 vepra penale** dhe janë zbuluar 1,288, ose **98%** e tyre.


TRAFIQET E PALIGJSHME



2.1.4 Krimet ndaj pronës dhe pasurisë

Gjatë vitit 2025, janë evidentuar **4641** vepra penale, janë zbuluar **4036** prej tyre, ose **86.96%**. (zbuluar 37 ngjarje të vjetra).Janë implikuar **5084** autorë, nga të cilët 984 të arrestuar, 556 të ndaluar, 2770 të ndjekur në gjendje të lirë, 773 të shpallur në kërkim policor/larguar. Krahasuar me vitin 2024, janë


evidentuar 418 ngjarje më shumë, ka patur një rritje të fuqisë zbuluese me **3.26%**, si dhe janë zbuluar 11 ngjarje të vjetra më shumë.



2.1.5 Krimi kibernetik

Gjatë vitit 2025 janë evidentuar gjithsej **1,308** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **859** ose **65.7%** e tyre. Në raport me vitin e kaluar janë evidentuar 98 vepra penale më shumë në fushën e krimit kibernetik, shprehur ndryshe është shënuar rritje me 8.1%. Janë implikuar gjithsej **1006** autorë, nga të cilët 97 autorë të arrestuar, 20 autorë janë ndaluar, 734 autorë janë proceduar në gjendje të lirë dhe 155 autorë janë larguar. Gjatë këtij viti është konstatuar:

- Ulje me 18.9% të veprave penale në fushën e mashtrimeve kompjuterike, lidhet me operacionet e suksesshme policore dhe fushatat e vazhdueshme ndërgjegjësuere.
- Ulja me 12.1% të veprave penale në fushën e falsifikimeve dhe ndërhyrjeve kompjuterike, lidhet me bashkëpunimin e suksesshëm me platformat META dhe TikTok, ku Policia e Shtetit, është e vetmja në rajon që ka akses të drejtëpërdrejtë në kanalet e raportimit të profileve dhe materialeve false.
- Rritje me 62.2% të veprave penale të pornografisë me të mitur, lidhet me intensifikimin e takimeve ndërgjegjësuere dhe edukuese mbi sigurinë në internet, të cilat kanë rritur besimin e të miturve dhe qytetarëve ndaj strukturave të hetimit të krimit kibernetik, duke sjellë një rritje të ndjeshme të raportimeve.



2.1.6 Siguria rrugore

Gjatë vitit 2025 kanë ndodhur **1,375 aksidente**, me 200 të vrarë dhe 231 plagosur rëndë. Në raport me vitin 2024 numri aksidenteve rrugore pësoi rënie me 17%, numri i viktimave në aksidente ka shënuar rritje me 12%, ndërsa numri i të plagosurve rëndë ka shënuar rritje me 6%.

Shkaqet kryesore të aksidenteve për vitin 2025 mbeten të njëjtat si vitet e mëparshme, duke përfshirë mosrespektimin e rregullave të qarkullimit rrugor, tejkalimin e shpejtësisë mbi normat e lejuara parakalimin e gabuar, ndryshimi i papritur i drejtimit, sjellja e këmbësorit dhe mos dhënia përparësi, përdorimin e celularëve gjatë udhëtimit, si dhe rritjen e numrit të automjeteve në qarkullim.

Gjatë vitit 2025 janë vendosur **1,203,926 masa administrative**, duke shënuar **rritje me 2%** në raport me vitin 2024. Ky tregues konsiderohet pozitiv pasi dëshmon rritjen e ndëshkueshmërisë për shkelësit e rregullave të qarkullimit rrugor.

Gjithashtu, me qëllim parandalimin e shkeljeve dhe disiplinimin e qarkullimit rrugor, nga ana e strukturave të Policisë Rrugore, janë marrë dhe masa administrative plotësuese të aplikuara ku:

- **1.914** shtetas të arrestuar për drejtim mjeti në gjendje të dehur,
- **1.549** shtetas të arrestuar për drejtim mjeti pa leje drejtimi,
- **3.326** leje drejtimi të pezulluara,
- **2.402** mjete të ndaluara,
- **381** mjete të sekuestruara.

2.1.7 Vepra penale në fushën e terrorizmit

Masat e marra për parandalimin e akteve terroriste dhe bashkëpunimi i ngushtë me shërbimet e inteligjencës dhe agjencitë ligjzbatuese në vend realizoi edhe për këtë vit mbajtjen në nivel të “ULËT” të kërcënimit edhe pse krahasuar me vitin 2021 janë shënuar 9 raste më shumë e veprave penale me qëllime terroriste. Gjatë vitit 2025 janë evidentuar gjithsej **44** vepra penale të lidhura me qëllime terroriste në Shqipëri dhe janë zbuluar **75%** e tyre. Krahasuar me vitin 2024, rezulton se numri i veprave penale është rritur me 33%. Rritja e zbulueshmërisë me 15%, nga 60% në vitin e kaluar në 75% në këtë vit, ka ardhur si rezultat i shtimit të rasteve të referuara për vepra penale që kryhen nëpërmjet internetit me adresa e-maili apo profile të pidentifikueshme në mediat sociale, si dhe vonesat e letër porosive që dërgohen për kompanitë e platformave online.


2.2 Lufta kundër Krimit të Organizuar

2.2.1 Hetimet proaktive

Referimet për grupe kriminale të krimit të organizuar bazuar në hetimet proaktive **janë rritur me 22.12% ose 275 hetime proaktive më shumë** krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2025 janë ndjekur 1518 hetime proaktive prej të cilave:

- 752 në fushën e krimit ekonomik e financiar;
- 347 në fushën e trafikeve të paligjshme;
- 283 në fushën e narkotikëve;
- 122 në fushën e krimeve kompjuterike;
- 14 në fushën e krimeve ndaj personit e pasurisë;

HETIMET PROAKTIVE




2.2.2 Operacione policore kundër krimit të organizuar

Janë zhvilluar gjithsej **663 operacione policore**, prej të cilave 130 janë zhvilluar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Krahasuar me vitin 2024 u zhvilluan **131** operacione, ose **25%** më shumë. Konkretisht:

- **311 operacione në fushën e narkotikëve**, 122 prej të cilave janë zhvilluar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.
- **159 operacione policore në fushën e trafikeve të paligjshme**, nga të cilët 2 në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.
- **127 operacione policore në fushën e krimit ekonomik – financiar**, 1 prej të cilave është zhvilluar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.
- **36 operacione policore në fushën e krimeve kundër personit dhe pasurisë**, nga të cilët 1 në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.
- **30 operacione policore në fushën e krimit kibernetik**, 4 prej të cilëve zhvilluar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.


OPERACIONET POLICORE



2.2.3 Grupe kriminale të goditura dhe vepra penale të referuara për grupet kriminale

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar gjatë vitit 2025 janë goditur gjithsej **26** grupe kriminale, 10 grupe ose 28% më pak se në vitin 2024. Në bashkëpunim me DVP dhe SPAK, në kuadër të procedimeve të ndjekura, janë goditur dhe vënë para përgjegjësisë shumë nga antarët e grupeve kriminale të krimit të organizuar, sidomos në qarqet Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan dhe Vlorë.

GRUPET KRIMINALE TË GODITURA



2.2.4 Asete të sekuestruara nga veprimtaritë kriminale

Gjatë vitit 2025 nga strukturat e Policisë së Shtetit janë sekuestruar dhe konfiskuar: **17,936,029 euro**, ku nuk janë përfshirë 115 pasuri të cilat janë ende të pavlerësuara nga AAPSK, pasuri që rrjedhin nga veprimtaria kriminale. Të ndara sipas bazës ligjore, si më poshtë:

U sekuestruan 16,896,687 euro pasuri që rrjedhin nga veprimtaria kriminale . Konkretisht: Për “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” (neni 287), u sekuestruan pasuri në vlerën **8,150,722 euro**. Në këtë vlerë nuk janë përlllogaritur 44 pasuri të sekuestruara. Në zbatim të Ligjit Nr.10192/2009, u sekuestruan pasuri vlerën **8,745,965 euro**.


Sekuestrime CASH gjatë ushtrimit të kontrolleve (n.287 dhe 287/b) kemi rreth **3,335,320 euro**.

U konfiskuan dhe kanë kaluar në favor të shtetit në 5 raste (4 vendime gjyqësore), 1,039,342 euro dhe 22 pasuri ende të pavlerësuara nga AAPSK.

Konfiskime sipas Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, i ndryshuar: në **3 raste, 1,039,342 euro** dhe 12 pasuri të pavlerësuara nga AAPSK.

Konfiskime sipas Nenit 287 i Kodit Penal, për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”: në 2 raste (1 vendim gjyqësor), 10 pasuri të pavlerësuara nga AAPSK.

VLERA E ASETEVE TË SEKUESRUARA NË EURO




2.2.5 Kultivimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike

Gjatë vitit 2025, janë evidentuar **3492 vepra penale në fushën e narkotikëve**, nga të cilat janë zbuluar **3438** ose 98.4% e tyre, janë proceduar penalisht 4529 persona, nga të cilët 1331 janë arrestuar/ndaluar, pra 29.4% prej tyre, 2991 janë ndjekur ne gjendje te lirë ose 66% dhe 207 janë shpallur në kërkim ose 4.6%. Janë evidentuar **637** vepra penale për kultivimin e bimëve narkotike, nga të cilat 106 janë hetime proaktive të regjistruara (53 realizuar) dhe 584 janë raste kultivimi të konstatuara nga strukturat e Policisë së Shtetit. Nga 584 rastet e evidentuara janë zbuluar 113, rritje e zbulueshmërisë me 4% në krahasim me vitin 2024. Bimë narkotike të kultivuara dhe të asgjësuara në vitin 2025, gjithsej 222,261 ose 15 % më pak se me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

2.2.6 Korrupsioni

Gjatë vitit 2025 janë evidentuar gjithsej **740** vepra penale për korrupsion, nga të cilat janë zbuluar 718 ose **97 %** e tyre. Në krahasim me vitin e kaluar rezultojnë 4 vepra më pak ose shprehur ndryshe është shënuar rënie me 1.5% e veprave penale në fushën e korrupsionit.

VEPRA PENALE NË FUSHËN E KORRUPSIONIT



2.3 Menaxhimi i Integruar i Kufirit dhe Migracionit

Në zbatim të Programit Vjetor të Policisë së Shtetit për vitin 2025, Strategjisë Ndër-sektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 dhe Planit të Veprimit 2024-2025, Policia e Shtetit e ka përqendruar punën në përsosjen e komponentëve të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe rritjen e standardeve të sigurisë kufitare, nëpërmjet kontrollit efektiv, parandalimit e goditjen e krimit ndërkufitar, rritjes së kapaciteteve dhe aftësive profesionale për menaxhimin e migracionit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar sipas standardeve të Bashkimit Evropian.


2.3.1 Hyrje –daljet në kufi

Gjatë vitit 2025 në Pikat e Kalimi e Kufitar janë evidentuar **në hyrje - dalje 41,926,764 shtetas** shqiptarë dhe të huaj në total, duke shënuar rritje me 7.4% krahasuar me vitin 2024, si dhe janë regjistruar në hyrje-dalje **10,985,816 automjete** ose 7 % më shumë se viti i kaluar.

2.3.2 Shtetas në kërkim të kapur në kufi

Gjatë vitit 2024 janë kapur në kufi **455 shtetas** në kërkim, nga të cilët **429** në kërkim kombëtar, **24** në kërkim ndërkombëtarë dhe **2** për autoritetet e Kosovës. Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë vitit 2025 janë kapur 14.3% shtetas në kërkim më pak krahasuar me vitin e mëparshëm.

SHTETAS NË KËRKIM TË KAPUR NË KUFİ



2.3.3 Kalim i paligjshëm i kufirit


Janë kapur **353 shtetas** shqiptar në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit, **18.1%** më pak ose ndryshe 78 shtetas më pak se gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2025 kërcënimet kryesore të cenimit të sigurisë kufitare kanë vijuar të mbeten trafiqet e paligjshme të lëndëve narkotike, përdorimi i dokumenteve të falsifikuara, kontrabanda, kalimi i paligjshëm i kufirit, dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, mosdeklarimi i vlerave monetare në kufi, qarkullimi i personave në kërkim etj. Rritje të dukshme kanë shënuar evidentimi i veprave penale, të “*Dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit*”, ku këtë vit janë evidentuar 44 raste kundrejt 25 rasteve të evidentuara gjatë vitit 2024, që rezulton me një rritje prej 19 raste më shumë ose e shprehur në përqindje me 76%.

2.3.4 Imigrantë në Republikën e Shqipërisë

Gjate këtij vitit janë kapur ne total 1,927 shtetas të huaj imigrantë të parregullt, prej të cilëve 1,694 për herë të parë dhe 233 përsëritës. Krahësuar me një vit më parë, janë kapur 387 shtetas më shumë ose rritje me 25%. Prej 1694 imigrantëve të kapur për herë të parë, 126 prej tyre kanë aplikuar për azil, për 87 është urdhëruar dëbimi dhe janë transportuar në Qendrën e Mbyllur për të Huajt, 42 janë urdhëruar për të qëndruar në një territor të caktuar, ndërsa për 1439 është lëshuar urdhër largimi vullnetar.


IMIGRANTË TË PARREGULLT



2.3.5 Menaxhimi dhe trajtimi i të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe trajtimi i kërkesave për vizë.

Referuar analizës së të dhënave për të huajt në territor, nga viti në vit, numri i imigrantëve në Shqipëri ka ardhur në rritje. Aktualisht në Shqipëri banojnë me qëndrim të rregullt **27514 të huaj**, nga të cilët **43.8%** të huaj banojnë në Tiranë. Numrin më të madh e zënë shtetasit nga Kosova me 6076 shtetas, Italia 3776 shtetas, India 2399 shtetas, Filipine 2213 shtetas, Egjypt 2007 shtetas, Turqi 1862 shtetas. Referuar Regjistrimit Elektronik për të Huajt (FER), gjatë vitit 2025 janë përpunuar **19321 aplikime** të shtetasve të huaj për leje qëndrimi, duke shënuar një rritje prej 46.6%, krahasuar me vitin 2024 ku ishin paraqitur 13176 aplikime për leje qëndrimi. Kjo rritje ka ardhur dhe si rezultat, i lehtësimit të procedurave për aplikim për shtetasit Kosovarë, si dhe ofrimi në një shërbim të vetëm on-line për leje qëndrimi dhe leje unike për shtetasit e huaj.

APLIKIME PËR LEJE QENDRIMI



2.4 Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar

Policia e Shtetit ka vijuar punën për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat ndërkombëtare policore, për parandalimin dhe luftën e përbashkët kundër kriminalitetit, duke i ofruar strukturave të Policisë së Shtetit një infrastrukturë ndërkombëtare të teknologjisë së lartë, në mbështetjeje teknike dhe operacionale, për të përballuar sfidat gjithnjë në rritje.

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin ka një partneritet të konsoliduar me EUAA (European Union Agency for Asylum), i fokusuar kryesisht në:

- ✓ Trajnime për procedurat e azilit, duke përfshirë modulën e intervistimit, vlerësimit të besueshmërisë, hartimit të vendimeve, menaxhimin e dosjeve dhe procedurat e mbrojtjes ndërkombëtare.
- ✓ Përafrimin me Paktin e Ri për Migracionin dhe Azilin, ku Shqipëria ka marrë pjesë në programet e bashkëtrajnimit dhe ka përfituar module të përkthyer në gjuhën shqipe.
- ✓ Ndërtimin e kapaciteteve të stafit, përmes programeve të certifikimit, trajnimeve online dhe sesioneve praktike të organizuara nga EUAA.
- ✓ Hartimin e dokumenteve strategjike, që fokusohen në standardet e pritjes, procedurat e identifikimit të grupeve vulnerabël dhe forcimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit.
- ✓ Ky bashkëpunim u thellua më tej nën Planin Rajonal të Trajnimit 2026, duke përfshirë edhe zhvillimin e moduleve në gjuhën shqipe dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në sesione të përbashkëta me Shtetet Anëtare të BE-së.

Marrëdhënia me Agjencinë Evropiane për Rojën Kufitare dhe Bregdetare (Frontex) përbën një nga shtyllat kryesore të bashkëpunimit ndërkombëtar. Elementet kryesore:

- Operacionet e përbashkëta në territorin shqiptar, veçanërisht pas hyrjes në fuqi të Statusit të Frontex në Shqipëri (i pari i këtij lloji me një vend jashtë BE-së).
- Patrullime të përbashkëta kufitare, angazhim i stafit të huaj në frontin operacional dhe shkëmbim i praktikave më të mira.
- Trajnime të specializuara për kontrollin kufitar, përdorimin e bazave të të dhënave, dokumentacionin e udhëtimit dhe identifikimin e falsifikimeve.
- Mbështetje në pajisje dhe teknologji si termokamera, pajisje vrojtimi dhe sisteme të avancuara komunikimi.
- Shkëmbim informacioni në kohë reale, veçanërisht në zonat me flukse migratore.

Janë ndjekur **22 Skuadra të Përbashkëta Hetimore (JIT-s)**, me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë si Italinë, Zvicrën, Francën, Finlandë, Maqedoninë e Veriut, Gjermaninë, Suedinë, Spanjën, Austrinë, DEA, SELEC.

- ✓ **17** nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, nga këto:
 - 15 JIT në fushën e narkotikëve
 - 2 JIT në fushën e krimit ekonomik e financiar
- ✓ **5** nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Kibernetike.

Gjatë vitit 2025, janë shkëmbyer gjithsej **39,035 informacione** me partnerët ndërkombëtarë, prej të cilave:

- ✓ Nga Interpol 25,115 informacione.
- ✓ Nga Europol 9,105 informacione.
- ✓ Nga Oficerët e Kontaktit 4,815 informacione.

Konstatohet një rritje prej 2.879 informacionesh, **ose 8% më shumë**, krahasuar me vitin 2024, kur u shkëmbyen 36,156 informacione.

Po ashtu, janë koordinuar në total nga Interpol, Europol dhe Oficerët e Kontaktit **243 operacione** të përbashkëta policore me partnerët ndërkombëtarë. Kjo përbën një rritje prej **11 operacionesh** më shumë, ose **4.7% më shumë**, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, kur u kryen 232 operacione të përbashkëta. Gjithashtu, janë koordinuar **308 takime** operacionale me partnerët ndërkombëtarë, krahasuar me vitin 2024, në të cilin janë koordinuan 200 takime operacionale, evidentohen **108 takime** më shumë, ose rritje me **54%**.

Gjatë kësaj periudhe, janë arrestuar gjithsej **127** persona me qëllim ekstradimi drejt vendit tonë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka një rënie prej **9** personash, ose **6.6% më pak**. Po ashtu, janë arrestuar me qëllim ekstradimi drejt vendeve të tjera, **165** persona drejt vendit tonë ose vendeve të tjera. Krahasuar me vitin 2024, evidentohet një rritje prej **36** personash, ose **27.9% më shumë**.

Në kuadër të Platformës EMPACT (European Multidisciplinary Platform Against Criminal Threats) (OAP) për vitin 2025, **janë koordinuar 14 operacione ndërkombëtare** si Projekti A.S.S.E.T, TRADO II, STREAM, PANDORA 9, VIDTF 16, ANEMONE etj, në drejtim të trafikimit të narkotikëve në kuadër të organizatës kriminale, pastrimit të parave, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, mashtrimit kibernetik.



III. AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Agjencia për Mbikëqyrjen Policore ka prioritet ushtrimin e ndikimit të vazhdueshëm në fushën e llogaridhënies policore, integritetit policor, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, si dhe përfshirjen gjithnjë e më shumë të kontrollit të jashtëm qytetar, ndaj Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera mbikëqyrëse. Gjatë vitit 2025 agjencia ka realizuar prioritetet dhe objektivat e planifikuara në lidhje me:

- veprimtarinë rregullatore dhe normative;
- bashkëpunime rajonale dhe trajnime;
- Agjencia Digjitale;
- hetimeve Proaktive dhe Hetimeve Procedurale Penale;
- hetimi Administrativ të Ankesave & Inspektimit;
- procesi i Vlerësimit Kalimtar (Vettingu);
- mbikëqyrja nëpërmjet CSP/Pastërtisë së Figurës.

3.1 Veprimtarinë rregullatore dhe normative

Veprimtaria e Agjencisë përgjatë vitit 2025 është fokusuar në implemenimin e ligjit organik, si dhe zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin e ndryshuar për Informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të 2 Vendimeve të Këshillit të Ministrave, 4 akteve normative të kompetencës së Ministrit të Punëve të Brendshme; 7 Plane Masash të Drejtorit të Përgjithshëm dhe 12 urdhrave të brendshëm të titullarit të institucionit për ndjekjen dhe zbatimin me korrektësi të rregullave dhe normave të parashikuara në ligj.

3.2 Bashkëpunime rajonale dhe trajnime

Agjencia ka rritur performancën e saj, nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm dhe të avancuar të 72 punonjësve të rinjve dhe ekzistues, në bashkëpunim me partnerët brenda dhe jashtë vendit si; ICITAP Albania, EU4LEA, Akademia e Sigurisë, OSBE, ILEA, FBI/SHBA, Bullgari, IPK/Kosovë. Gjithashtu, agjencia ka vijuar konsolidimin e bashkëpunimit rajonal nëpërmjet 2 takimeve ë nivel drejtues, si dhe 1 trajnim në kuadër të “*Forumit Rajonal të Agjencive të Mbikëqyrjes Policore*”, ndërmjet agjencive homologe të 4 vendeve të Ballkanit Perëndimor ku bëjnë pjesë Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Shqipëria. Angazhimi dhe përfaqësimi në takimet ndërkombëtare ka qenë nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtuesve të lartë të agjencisë dhe personelit teknik në 2 konferenca vjetore të EUROPOL-it përkatësisht:

- “*Të Drejtat themelore të policimit*” & “*Mbi korrupsionin në organet e zbatimit të ligjit*”;


- “Konferenca e 24-të Profesionale Vjetore dhe Asambleja e Përgjithshme e EPAC/EACN” si dhe “Konferenca Vjetore 2025 e Poligrafit – Shoqata Amerika e Poligrafit”.

3.3 Agjencia Digjitale

Agjencia vuri në dispozicion të qytetarit aplikacionin “Agjencia Dixhitale”, aktiv në të dy sistemet kryesore të telefonave celularë, i cili mund të shkarkohet nga çdo qytetar i interesuar. Ky aplikacion u ofron qytetarëve një mjet të ri, të drejtpërdrejtë dhe të thjeshtë, si dhe në kushte të anonimatit të plotë, për të raportuar çdo shkelje apo abuzim nga punonjës të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës apo Shërbimit Zjarrfikës, tre autoritetet që mbikëqyren nga agjencia.


3.4 Hetimeve Proaktive dhe Hetimeve Procedurale Penale

Gjatë vitit 2025, ka pasur një rritje të efikasitetit të hetimeve proaktive në funksion të goditjes së paligjshmërisë, në radhët e punonjësve të strukturave, duke synuar nivelet e larta, të mesme, e parë drejtues të menaxhimit policor, jo vetëm ato në nivelet zbatuese/operacionale, e cila reflektohet në treguesit sasior e cilësor të veprimtarisë hetimore, shprehur me përqindje, si më poshtë vijon:




Nga strukturat e hetimit të agjencisë gjatë vitit 2025 janë referuar pranë organit të ndjekjes penale **336 referime** penale për **444** punonjës të strukturave, përkatësisht: 95 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 330 punonjës policie të nivelit zbatues, 9 punonjës civil (administrativ), 9 efektive të Gardës, 1 punonjës i PMNZSH dhe 62 shtetas. Numri i punonjësve të referuar krahasuar me vitin 2024 ka pasur një rënie me 19 raste më pak.

Numri i punonjës të referuar Krahasimi në vite 2021-2025




Të dhënat sipas grafikut të mëposhtëm tregojnë se, krahasuar me vitet e mëparshme numri i referimeve penale është në rritje, në 5-vjeçarin e fundit.

Numri i referimeve Krahasimi në vite 2021-2025



Krahas referimeve nga strukturat e hetimit të agjencisë, në cilësinë dhe përmbushjen e attributeve të Oficerit të Policisë Gjyqësorë, janë kryer me iniciativë ndalimet/arrestimet në kushtet e flagrancës, si dhe ekzekutuar vendimet e gjykatave, për **133 persona**, prej të cilëve 26 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 78 punonjës policie të nivelit zbatues, 5 punonjës administrative, 5 punonjës të Gardës së Republikës, 1 punonjës i PMNZSH dhe 18 shtetas.

Numri i personave të arrestuar/masa sigurie Krahasimi në vite 2021-2025




3.5 Hetimi Administrativ i Ankesave & Inspektimit

Veprimtaria administrative në aspekt krahasimor për vitin **2024-2025** rezulton se:

- Numri i telefonatave tek **linja jeshile 08009090**, gjatë vitit 2025 është **3846** telefonata dhe krahasuar me vitin e kaluar, ka rritje me **512** telefonata më shumë ose **15%** më shumë.
- Numri i ankesave të marra nëpërmjet të gjitha portaleve të komunifikimit të vënë në dispozicion për qytetarët është **1677** ankesa, përkatësisht: 513 ankesa nëpërmjet adresës së email-it ankesa@amp.gov.al, 331 ankesa nëpërmjet postës zyrtare, 252 ankesa pranë Drejtorive Rajonale të Agjencisë, 241 ankesa në Zyrën e Ankesave të AMP-së, 134 ankesa nëpërmjet Sistemit të Raportimit (Agjencia Dixhitale), 126 ankesa nga institucionet e tjera të administratës, 71 ankesa nga Portali i Bashkëqeverisjes, 5 ankesa nga rrjetet sociale/media dhe 4 ankesa nga Avokati i Popullit/
- Janë kryer **40 inspektive, prej të cilave 18 inspektive janë të planifikuara dhe 22 inspektive janë të paplanifikuara**. Inspektive të planifikuara janë realizuar mbi bazën e analizës së riskut për strukturat me risk më të lartë korrupsionit apo veprimeve të tjera të kundërligjshme, njëkohësisht dhe për të kontrolluar dhe mbikëqyrur realizimin e rekomandimeve të lëna në inspektimet e kryera në vitet apo periudhat e mëparshme.
- Numri i punonjësve të policisë, për të cilët në përfundim të hetimit administrativ janë rekomanduar për fillimin e hetimit disiplinor për “*shkelje të rënda*” pranë Komisionit të Hetimit Disiplinor të Agjencisë dhe për “*shkelje të lehta*”, në Drejtorinë e Standardeve Profesionale të Policisë së Shtetit, është konkretisht **108** punonjës policie nga të cilët 46 punonjës policie të nivelit të parë drejtues dhe 62 punonjës policie të nivelit zbatues është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor për “*Shkelje të rëndë*” & “*Shkelje të lehtë*” pranë Komisionit të Hetimit Disiplinor të Agjencisë dhe Drejtorisë së Standardeve Profesionale të Policisë së Shtetit.

Hetime disiplinore viti 2025



3.6. Procesi i Vlerësimit Kalimtar (Vettingu)

Trupat vlerësuese të agjencisë kanë kryer procesin e hetimit administrative për vlerësimin kalimtar për të tre komponentët “figura, pasuria dhe profesionalizmi” duke përmbyllur këtë proces për 72 subjekte dhe hedhja e 2 shorteve të reja për **72 subjekte** nga Policia e Shtetit, Garda e Republikës dhe Agjencia.

3.7 Mbikëqyrja nëpërmjet CSP/Pastërtisë së Figurës

Gjatë vitit 2025, Agjencia në cilësinë e një prej tre Autoriteteve Verifikuese në vend, sipas përcaktimit të V.K.M. nr.731, datë 27.11.2024 “*Për miratimin e Rregullave për Sigurimin e Personelit*”, ka organizuar dhe ndjekur punën për procesin e verifikimit të kushtit të sigurisë duke trajtuar **6225** praktika, për **3372** aplikantë nga të cilët, **1487** subjekte të strukturave, objekt i veprimtarisë së AMP-së. Në përfundim të procedurave aplikuese dhe verifikuese nga ana e Agjencisë, për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së saj, AKSIK ka vendosur që:

- ✓ **10** punonjësve t’u “hiqet CSP-ja”;
- ✓ **19** punonjësve t’u “refuzohet pajisja me CSP-ë”;
- ✓ **4** punonjësve t’u “pezullohet përkohësisht CSP-ja”.

Agjencia ka parashikuar përmbushjen e prioritete dhe objektiva, në përputhje e zbatim të prioriteteve të qeverisë shqiptare & Ministrisë të Punëve të Brendshme në fushën e sigurisë, zbatimit të ligjit & të mbikëqyrjes së jashtme policore, të rekomandimeve në Raport Progresin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, si dhe të rekomandimeve e sugjerimeve të partnerëve tanë më të ngushtë ICITAP Albania e EU4LEA, e konkretisht:

- Angazhimi në **aplikimin me cilësi e efikasitet të metodikave bashkëkohore të karakterit parandalues**, si: Inspektimi i performancës, Vettingu (vijimi i Vlerësimit Kalimtar & fillimin e Vlerësimit Periodik), Trajtimi i ankesave, CSP, Hetimi administrative apo & Veprimtaria inteligjente, pa ulur cilësinë e veprimtarisë Hetimore Procedurale.
- **Forcimi dhe rritja e bashkëpunimit** kryesisht me Prokurorinë e Posaçme (SPAK), Prokuroritë e Shkallës së Parë, Policinë e Shtetit, SHISH, AISM, AKSIK, etj do të jetë prioritet i punës sonë.
- Forcimi i kapaciteteve të brendshme të Agjencisë, **nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes në sasi e cilësi të infrastrukturës logjistike, teknike**, sisteme e programe të teknologjisë bashkëkohore, nga njëra anë dhe trajnimit të vazhduar dhe të avancuar të personelit nga ana tjetër.
- Konsolidimi i **bashkëpunimit rajonal** si pjesë e “Forumit Rajonale të Organizmave të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes Policore” të vendeve të Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.
- Përbushja e detyrimeve të agjencisë që rrjedhin nga Strategjitë Ndërsektoriale dhe Planet Konkrete të Veprimit e angazhimit të vazhdueshëm në Grupet Ndërinstitucionale të Punës **për ndjekjen dhe përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga rekomandimet e lëna nga BE** për institucionet shqiptare, në kuadër të aderimit të Shqipërisë në BE-në.
- **Rritja e besimit dhe bashkëpunimit** me qytetarët do të vazhdojë të jetë busulla jonë orientuese për një shoqëri më të sigurt dhe të qetë falë punës dhe përkushtimit të punonjësve të ndershëm dhe profesionistë ligjit.



VI. GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Garda e Republikës ka vepruar në përputhje të plotë me ligjin “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, prioritetet e qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke u përshtatur njëkohësisht me situata apo ngjarje të paparashikuara. Gjatë vitit 2025 ka përmirësuar zhvillimit profesional të punonjësve dhe forcimin e praktikave të punës, me synim rritjen e performancës së institucionit në përbushje të prioritetëve dhe objektivave. Nëpërmjet profesionalizmit stërvitjes intensive dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të personelit, ka forcuar kapacitetet operacionale duke rritur besueshmërinë, si një garant i stabilitetit dhe sigurisë. Vizioni i Gardës së Republikës, përveç sa citohet më sipër, lidhet edhe me bashkëpunimet me institucionet shtetërore, institucionet ndërkombëtare dhe partnerët strategjikë, duke promovuar kështu transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin.

Garda e Republikës e drejton punën përmes disa objektivave të rëndësishme, si më poshtë vijon:

- **përmirësimi i performancës** së strukturave operacionale dhe atyre mbështetëse;
- **rritja e nivelit të sigurisë** nëpërmjet shtimit të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit;
- **zhvillimi i sistemit të teknologjisë** së informacionit;
- **rritja e transparencës** dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Gardës së Republikës.

4.1 Ndryshimet dhe përmirësimi i kuadrit ligjor

Përgjatë vitit 2025, ligji 33/2021 “Për Gardën e Republikës”, nuk ka pasur ndryshime, por sa i përket paketës së ankeve nënligjore në zbatim të ligjit, janë miratuar 2 vendime përkatësisht:

- miratuar VKM nr. 402, datë 16.7.2025 “Për përcaktimin e rregullave procedurave dhe të kohëzgjatjes së mbrojtjes personale dhe banesës së personaliteteve të tjera në përfundim të detyrës”;
- VKM nr.576, datë 8.10.2025 “Për një ndryshim të vendimit nr. 478, datë 10.07.20219 të Këshillit të Ministrave “Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”, të ndryshuar.

Në përmbushje të misionit dhe detyrave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore Garda e Republikës kryen veprimtaritë si më poshtë vijon:

- kryen shërbim ceremonial;
- përcakton zonën e sigurisë, skemat e ruajtjes së bashku me planet e dislokimit, ato operacionale, si dhe vendos kontakte me institucionet ligjzbatuese;
- grumbullon dhe përpunon informacione nga strukturat për garantimin e sigurisë në vend;
- përdor aparatura teknologjike të posaçme në funksion të sigurisë së personaliteteve dhe objekteve në ruajtje;
- bashkëpunon dhe ndërvepron me Policinë e Shtetit dhe shërbimet inteligjente etj., për ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve apo objekteve në ruajtje.

Gjatë vitit 2025, ka pasur një rritje të konsiderueshme të aktivitetit operacional, ku strukturat e Gardës kanë arritur ta realizojnë me sukses përmbushjen e objektivave, me qëllim rritjen e besueshmërisë sa i përket shërbimit të sigurit, personaliteteve si dhe objekteve.

4.2 Samiti i gjashtë i Komunitetit Politik Evropian (KPE) dhe Ministeriali i Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore (SEECP)

Më datë 16 maj 2025 Shqipëria priti Samitin e gjashtë të Komunitetit Politik Evropian (KPE), Tiranë duke mbledhur 47 drejtues shtetesh dhe qeverish, së bashku me institucionet kryesore evropiane dhe ndërkombëtare, përkatësisht **53 delegacione**, Garda e Republikës tregoi përkushtim,

seriozitet, bashkëpunim dhe profesionalizëm në realizimin me sukses të mbarëvajtjes së sigurisë së këtij aktiviteti. Një angazhim impenjativ aq sa edhe me përgjegjësi institucionale.

Më datë 16 qershor, në kuadër të organizimit të ministerialit të Procesit të Bashkëpunimit në Evropën Juglindore, SEECP, me pjesëmarrje të 13 lidërve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit, Garda e Republikës ka ndihmuar në sigurimin e gjithë aktivitetit dhe pjesëmarrjeve në të. Ky aktivitet kërkoi angazhim dhe përkushtim maksimal nga strukturat institucionale dhe disa nga masat më të rëndësishme që janë marrë për mbarëvajtjen e aktivitetit janë:

- **krijimi dhe ruajtja e perimetrit të sigurisë** së zonës së zhvillimit të ministerialit në bashkëpunim me Policinë e Shtetit;
- **Marrja në ruajtje e objekteve** të përkohëshme;
- **Sigurimi i rrugëkalimeve** për çdo intinerar lëvizjeje të delegacioneve;
- **Kontrolli kimiko-xhener** me aparatura të posaçme;
- **Hulumtimi, analizimi** dhe sigurimi i çdo informacioni.

Gjithashtu, në hyrje të perimetrit në dy aktivitete të organizuara, është kryer kontroll i çdo personi të akredituar për të patur akses në ambientet e dedikuara të tij, me skaner dhe urë detektore.


4.3 Aktivitete të tjera të rëndësishme gjatë vitit 2025

Aktivitete të tjera të rëndësishme të kryera gjatë vitit 2025, janë si më poshtë vijon:

- Ruajtja dhe mbrojtja e personaliteteve të huaja gjatë zhvillimit të takimit të kryetarëve të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Europiane, më datë 27 shkurt–1 mars 2025 (22 delegacione);
- Takimi i Prokurorëve të Eurojust dhe Rajonit datë 16-17 qershor (3 delegacione);
- Konferenca e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Europës Juglindore (6 delegacione);
- Marrjen e masave të sigurisë për personalitetet pjesëmarrëse në Samitin e Brdo-Brijunit i organizuar nga Presidenti i Republikës;
- Marrja e masave të Sigurisë në Samitin e Kryeministrave të rajonit të organizuar në Pallatin e Kongreseve.


Gjatë vitit 2025 ka hartuar **607** plane operacionale në zbatim të sigurisë së personaliteteve gjatë veprimtarive të tyre vjetore, përkundrajt **552** planeve të hartuara gjatë vitit 2024. Gjatë këtij viti raportues, ka pasur rritje të kryerjes së planeve operacionale, duke rritur angazhimin dhe profesionalizmin e Gardës së Republikës.

Plane operacionale Krahasim viti 2024-2025



Për sigurinë e PLSH dhe PSH-së, janë kryes shërbime të shumta, prej të cilave numri më i lartë i shërbimeve është kryer për Policinë e Shtetit me 3104 shërbime dhe numri më i ulët është kryer për Presidentin e Republikës me 236 shërbime, përkatësisht reflektuar sipas tabelës së mëposhtme.

Shërbime sigurie viti 2025



Gjatë vitit raportues janë marrë masa për sigurinë e delegacioneve të huaja që kanë vizituar Shqipërinë apo kanë marrë pjesë në takime, samite apo organizime me pjesëmarrje të lartë të personaliteteve homologe. Nga sektori i delegacioneve janë kryer **823** shërbime sigurie, kundrejt **646** shërbimeve të kryera në vitin 2024.

Shërbimet rutinë për sigurinë fizike që Garda ka për ruajtjen e sigurisë së organeve të drejtësisë, ka kryer:

- shërbime sigurie gjatë zhvillimit të **114** seancave nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;

- **611** shërbime sigurie gjatë zhvillimit të aktiviteteve jashtë objektit të veprimtarisë së përditshme, Tiranë;
- **1372** shërbime sigurie gjatë zhvillimit të veprimtarive të Policisë së Shtetit;
- **19** shërbime sigurie jashtë vendit.

4.4 Trajnime, kurse dhe kualifikime

Përgjatë vitit 2025, ka pasur një rritje dhe përmirësim të kurseve/ trajnimeve, të cilat janë zhvilluar në vijim të programeve të përmirësuara në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë. Disa nga kurse/trajnimet e realizuara janë si më poshtë vijon:

- Kursi për punonjësit e gardës me arsim të lartë jo policor në Akademinë e Sigurisë, ku morën pjesë **34 punonjës**, është realizuar 2.06.2025-28.07.2025.
- Kurs trajnimi me temë “Kurs për specialitetin e xhenjos”, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ku morën pjesë **2 punonjës** të gardës, është realizuar 09.06.2025-01.08.2025.
- Trajnim “Kurs bazë të zhytjes në Bazën Detare Pashaliman Vlorë”, ku morën pjesë **8 punonjës** të gardës, është realizuar 17.06.2025-4.07.2025.
- Kursi për formim të përgjithshëm për punonjës të nivelit bazë, në Akademinë e Sigurisë, ku morën pjesë **31 punonjës** të Gardës së Republikës, është realizuar 1.09.2025-27.10.2025.
- Trajnim “Për drejtimin e sigurit të mjeteve të blinduara”, në Akademinë e Sigurisë, ku morën pjesë **10 punonjës** të Gardës së Republikës, është realizuar 15.12.2025-19.12.2025.
- Trajnim “Komunikimi në inteligjencën artificiale”, në Republikën e Turqisë, Ankara, ku morën pjesë **2 punonjës** të Gardës së Republikës, është realizuar 1.09.2025-05.09.2025.
- Kurs “Menaxhimi i turmave”, në Republikën e Turqisë, Izmir, ku morën pjesë **14 punonjës** të Gardës së Republikës, është realizuar 15.09.2025-26.09.2025.
- Kurs i Mbrojtjes, në Republikën e Turqisë, Ankara, ku morën pjesë **5 punonjës** të Gardës së Republikës, është realizuar 6.10.2025-31.10.2025.
- Kurs “Trajnim për Sigurinë personale”, në Republikën e Hungarisë, Budapest, ku morën pjesë **7 punonjës** të Gardës së Republikës, është realizuar 27.10.2025-31.10.2025.
- Trajnim “Për zbulimin e armëve të zjarrit, eksplozivë të paligjshëm, në Republikën e Sllovakisë, ku mori pjesë **1 punonjës** i Gardës së republikës, është realizuar 02.11.2025-07.11.2025.


Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka prioritet mbrojtjen e territorit në fushën e ndërtimit, mjedisit dhe pyjeve. Gjatë vitit 2025 IKMT në zbatim të legjislacionit në fuqi, ka konstatuar, kontrolluar dhe parandaluar çdo shkelje: në fushat e planifikimit urban, lejet e ndërtimeve, rregulloreve përkatëse, krimeve mjedisore dhe mbrojtjes së pyjeve, duke vepruar me vendosmëri dhe i pakushtëzuar në vendimmarrje. Përmes përforcimit të infrastrukturës teknologjike dhe digjitalizimit, IKMT ka mundur, kontroll më të plotë dhe të detajuar të territorit me qëllim parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe lirimin e hapësirave publike të zëna në mënyrë të paligjshme. Gjatë vitit 2025 IKMT, nëpërmjet qasjes profesionale duke bashkëpunuar me strukturat ligjzbatuese ka realizuar:

- **rritjen e performancës** në drejtimin e mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundraligjshme;
- **mbikëqyrjen e zonave** me qëllim parandalimin e punimeve/ ndërtimeve të paligjshme;
- **realizimin me korrektësi të inspektimeve** sipas përcaktimeve të akteve ligjore;
- **mundësimin e zgjedhjeve** sa më efikase për shmangien e sa më shumë pasojave të zhvillimeve të paligjshme në territor.

5.1 Vendime dhe inspektime nga IKMT për vitin 2025

Në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë në respektimin e normave dhe standardeve në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit dhe disiplinimit të punimeve në ndërtim, IKMT ka ndërmarrë një sërë veprimesh duke kryer inspektime dhe marrë vendime në përmbushje të dispozitave dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përgjatë vitit 2025 numrin më të madh të vendimeve të marra, e zënë vendimet e marra për objekte/ndërtime të prishura të cilat janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin/VKM për shpronësim me **447 vendime**. Numri më i vogël i vendimeve të marra është në fushën e pyjeve me **9 vendime** për dënim me gjobë, përkatësisht sipas tabelës së mëposhtme.


Vendime IKMT për vitin 2025



Gjatë vitit 2025 nga Drejtoritë Qendrore të Inspektoratit Kombëtar dhe nga Drejtoritë Rajonale të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit janë kryer inspektime intensive, ku në total janë kryer **7306 inspektime**, prej të cilave 3324 inspektime nga drejtoritë qendrore dhe 3882 inspektime nga drejtoritë rajonale.

Drejtoritë qendrore IKMT-së, sipas grafikut të mëposhtëm, reflektohen inspektimet më të larta në fushën e ndërtimit me 1816 inspektime dhe numri më i ulët i inspektimeve është kryer në fushën e mjedisit në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

Inspektime nga Drejtoritë Qendrore 2025



Drejtoritë Rajonale të IKMT-së Drejtoritë Rajonale përgjatë vitit 2025 kanë punuar në të gjithë territorin e vendit për parandalimin e ndërtimeve pa leje, si dhe kontrollin e mjedisit dhe pyjeve nga veprimet e kundraligjshme. Në zbatim të akteve ligjor dhe nënligjor, kanë realizuar **3882 inspektime** në total, prej të cilave numri më i lartë është shënuar në fushën e ndërtimit me 1685 inspektime, ndërsa numri më i ulët është shënuar në inspektimet e realizuara me Policinë e Shtetit.

Inspektime dhe bashkëpunime nga Drejtoritë Rajonale viti 2025




5.2 Zbatimi i projekteve madhore

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit përveç inspektimeve të realizuara në territor, në përputhje me përcaktimet ligjore sipas fushës së përgjegjësisë, ka ndërmarrë veprime në kuadër të zbatimit të projekteve madhore të qeverisë, të cilat janë kryer në bashkëpunim me strukturat e tjera ligjzbatuese, kryesisht Policinë e Shtetit.

- Projekti “*Rishikimi për Segmentin Rrugor të vazhdimin të Unazës së Madhe Tiranë*”, nga “*Sheshi Shqiponja*”, tek “*Bulevardi i ri*” dhe Rikualifikimi i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6, është realizuar prishja e **6 objekteve** të trajtuara me VKM shpronësimi.
- Projekti “*Rikualifikimi i Hyrjes së Qytetit të Shkodrës dhe bregdetit perëndimor të liqenit të Shkodër*”, është realizuar prishja e **20 objekteve** me VKM shpronësimi.
- Projekti “*Lungomare Faza 3 dhe 4 në vijen bregdetare Vlorë-Orikum*”, si dhe prishjen e objekteve pengesë për realizimin e projektit për lidhjen e rruges transballkanike për në portin e vlorës, është realizuar prishja e **30 objekteve**.
- Projekti “*Zgjerim aksi rrugor dalje e Elbasan-Librazhd- Qafë-thanë*”, është realizuar prishja e **25 objekteve**.


Numri i objekteve të prishura sipas projekteve viti 2025



5.3 Bashkëpunimi me IMT-të e bashkive dhe mbrojtja e parqeve me rëndësi kombëtare


Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është angazhuar në rritjen e parametrave të sigurisë rrugore për prishjen e mureve rrethuese, kioskave dhe objekteve të ndryshme që çënojnë sigurinë rrugore, si dhe është realizuar prishja e **64 objekteve** (sipas grafikut të mëposhtëm), si dhe është ndërhyrë në prishjen e **35 objekteve** për ekzekutimin e prishjes të marrë nga IKMT në bashkitë: Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Himarë, Sarandë, Tropojë, Lezhë, Krujë dhe Kavajë. Gjithashtu Drejtoria e Mjedisit dhe Pyjeve ka shërbyer si mbështetje e vazhdueshme për Drejtoritë Rajonale të IKMT-së, me qëllim sekuestrimin dhe shoqërimin e mjeteve.

Numri i kioskave të prishura viti 2025



Me qëllim mbështetjen e strukturave të IMT-ve në bashki, Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit, ka vepruar dhe mbështetur strukturat me qëllim lirim të hapësirave publike dhe parqeve Kombëtare. Nga përqendrimi i operacioneve dhe ndërhyrjeve nga strukturat e IMT dhe IKMT, rezulton se numri më i lartë i objekteve pa leje, ka qenë në zonën e Thethit me **130 objekte** të prishura dhe numri më i ulët në zonën e Durrësit me **11 objekte** të prishura.

Numri i objekteve të prishura në mbështetje të IMT-ve bashki viti 2025




5.4 Mbrojtja e vijës bregdetare

Aksioni për lirim të hapësirave publike përgjatë vijës bregdetare, ka qenë intensiv dhe në bashkëpunim edhe me Policinë e Shtetit, është realizuar prishja e objekteve pa leje dhe rikthimi i hapësirave publike për qytetarët. Nëpërmjet këtij procesi është rritur performanca me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, si dhe është mundur zgjedhje sa më efikase për shmangien e pasojave të zhvillimeve të paligjshme në territor.

Edhe gjatë vitit 2025 mbrojtja e vijës bregdetare, mbetet prioritet i IKMT-së dhe në bashkëpunimin me Policinë e Shtetit, ka liru hapësirat publike të zaptuara pa leje nga pronarë subjektsh që operojnë përgjatë vijës bregdetare në vendin tonë dhe janë kryer **106** prishje objektsh ku krahasuar me vitin 2024, ka një rritje me **22** objekte të prishura më shumë, përkatësisht sipas grafikut të mëposhtëm.


Mbrojtja e vijës bregdetare objekte të prishura Krahasimi viti 2024 - 2025



Lirimi i hapësirave publike në bregdet

Numri i objekteve të prishura përgjatë vitit 2025 në vijën bregdetare shënon **106 objekte** dhe numri më i lartë shënohet në vijën bregdetare të Kepit të Rodonit me 67 objekte të prishura dhe numri më i ulët në vijën bregdetare Shëngjin, Shirokë dhe Velipojë me 2 objekte të prishura, përkatësisht sipas të dhënave të reflektuara në tabelën e mëposhtme.

Numri i objekteve të prishura përgjatë vijës bregdetare viti 2025




5.5 Ankesa dhe Platforma e Bashkëqeverisjes

Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka vijuar procedurat e tij administrative në përputhje me kuadrin ligjor, dhe si rezultat gjatë vitit 2025 është kryer trajtimi i **11012** shkresave/ankesave dhe **67** nga Platforma e Bashkëqeverisjes, për kthimin e përgjigjeve të shkresave dhe kërkesave të paraqitura për vënien në funksion të informacionit nga individët kërkuar (reflektuar në grafikun e mëposhtëm).

Gjithashtu, implementimi i “Open Data”, ka ndikuar në rritjen e transparencës dhe lehtësimin për aksesim nga qyteratët, studiuesit dhe palët e interesuara rreth veprimtarisë së IKMT-së. Përditësimet në faqen zyrtare të IKMT-së, ku është implementuar platforma “Hapësira ime”, ka

ndikuar në lehtësimin dhe adresimin e ankesave/kërkesave nga qytetarët, për zgjidhje të problematikave të shtruara për institucionet shtetërore.

Shkresa/ankesa & Platforma e Bashkëqeverisjes



Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka hartuar duke evidentuar aktivitetet e kryera bazuar në detyrimet që rrjedhin nga VKM nr.737/2017 “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, i ndryshuar, VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku”, VKM nr. 81, datë 14.2.2023 për miratimin e “Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023 – 2025” dhe të

planeve të veprimit 2023-2025”.Gjatë vitit 2026 Qendra për Koordinimin Kundër Ekstremizmit të dhunshëm ka realizuar prioritetet e planifikuara ku ka pasur bashkëpunim të ngushtë me institucionet shtetërore përgjegjëse nga fusha e saj e veprimit dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC), që veprojnë në fushën e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm përkatësisht në lidhje me:

- Fuqizimin e institucioneve publike dhe komuniteteve për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- Procesin e rehabilitimit/riintegrit/risocializimit për personat e kthyer nga zonat e konfliktit Siri/Irak.

QKEDH-ja ka vijuar angazhimin e saj në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025 dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj. Gjatë 2025 QKEDH-ja është angazhuar në zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe jo shtetërorë të përfshirë në masat kundër ekstremizmit të dhunshëm, me fokus në:

- **Fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitutional në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar**, duke konsoliduar lidhjet me institucionet ligjzbatuese dhe aktorët e tjerë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- **Fuqizimin e mekanizmave të referimit për shkëmbimit të informacionit ndërmjet aktorëve institucionalë dhe strukturave të përfshira**, për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e radikalizmit;
- **Rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike** përmes programeve të trajnimit të dedikuar për identifikimin dhe referimin e shenjave të hershme të radikalizmit;
- **Fuqizimin e kapaciteteve për rehabilitim dhe riintegrim të personave të radikalizuar** ose të kthyer nga zonat e konfliktit, duke siguruar mbështetje të specializuar dhe qasje të koordinuar;
- **Mbështetjen ekonomike të familjeve të prekura**, përmes përfshirjes në programe punësimi dhe kurse kualifikimi, me synim reduktimin e faktorëve të riskut social.

6.1 Fuqizimi i Komiteteve Rajonale dhe realizimi i trajnimeve për stukturat ligjzbatuese

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 185/2023, QKEDH ka vijuar me fuqizimin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar **27 takime** të Komiteteve Rajonale në 12 qarqet e vendit, duke siguruar vazhdimësinë e punës dhe koordinimin ndërinstitutional. Paralelisht janë organizuar **24 sesione** trajnimi me qëllim rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve Rajonale dhe Sekretariateve të tyre Teknike duke përmirësuar aftësitë për zbatimin e masave parandaluese. Gjithashtu, kanë vazhduar raportimet tremujore drejtuar Koordinatorit Kombëtar për P/KEDH duke garantuar ndjekje të progresit në përputhje me detyrimet ligjore.

Në kuadër të këtij angazhimi, janë trajnuar **591 punonjës së Policisë së Shtetit**, përfshirë Oficerë të Patrullës së Përgjithshme (OPP), Specialistë të Policisë në Zonë (SPZ) dhe Punonjës të Policisë Kufitare. Gjithashtu, në kuadër të projektit CIVIPOL për Mbrojtjen e Hapësirave Publike, janë koordinuar **5 trajnime rajonale** (një prej të cilëve online) me pjesëmarrjen e **19 oficerë drejtuesve** dhe oficerëve të lartë të Policisë së Shtetit, së bashku me kolegë nga vende të tjera të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu është vazhduar bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile, duke organizuar **7 trajnime** të dedikuara për aktorët e vijës së parë. Edhe përgjatë vitit 2025 ka vijuar bashkëpunimi dhe koordinimi **si pikë fokale për projektin evropian** “*Rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturave kritike në Ballkanin Perëndimor*” të zbatuar nga CIVIPOL, ku ka koordinuar pjesëmarrjen në:

- **Seminarin Rajonal** “Mbështetje për autoritetet publike në krijimin e rekomandimeve praktike dhe materialeve udhëzuese për: planet e sigurisë për soft-targets, fushatat e ndërgjegjësimit publik, programet e ndërgjegjësimit për kërcënimet e brendshme”.
- **Seminarin Rajonal** “Shkëmbimi i praktikave më të mira për, strategjitë për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, zhvillimi i strategjive kombëtare të qëndrueshmërisë sipas Direktivës CER, ushtrime operationale në terren me përfshirjen e sektorit privat (pasja PPP).
- **Takimin e 5-të të Bordit Drejtues të projektit evropian** “Rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturës kritike në Ballkanin Perëndimor”, zbatuar nga CIVIPOL, mbajtur në Tiranë me përfaqësues nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësues të autoriteteve Franceze, Kroate, Italiane dhe Greke.
- **Seminare online**, që trajtojnë dy komponentët përkatësisht, rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturës kritike në Ballkanin Perëndimor, mbrojtjen e Hapësirave Publike dhe Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike, mbi legjislacionin, praktikat e mira dhe mundësitë për partneritete publike dhe private në fushat e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturave kritike me theks të veçantë qasjen “siguria që në konceptim” (security-by-design).


6.2 Edukimi dhe ndërgjegjësimi në komunitet

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar një sërë trajnimesh mbi të drejtat e njeriut dhe tolerancën fetare, me pjesëmarrjen nxënësve të sistemit parauniversitar dhe të rinjve në qytetet Cërrik, Kavajë, Fier dhe Pogradec. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë rritja e njohurive, aftësive kritike dhe ndërgjegjësimit të të rinjve për respektimin e diversitetit, promovimin e bashkëjetesës paqësore dhe forcimin e reziliencës ndaj narrativave polarizuese ose diskriminuese.

Gjithashtu janë zhvilluar disa takime informuese dhe diskutime tematike me gra dhe të rinj në disa bashki të vendit, të cilat janë fokusuar në identifikimin dhe kuptimin e shenjave të hershme të radikalizmit, si dhe në nxitjen e angazhimit komunitar për parandalimin e tij. Këto takime kanë synuar forcimin e rolit të komunitetit në raport me sigurinë dhe parandalimin, si dhe ofrimin e

mjeteve praktike për të njohur dhe adresuar faktorët që mund të çojnë drejt radikalizimit ose marginalizimit. Përgjatë vitit 2025 QKDHE ka kryer trajnime, takime dhe seanca informuese me përfaqësues të ndryshëm të komunitetit, në zbatim të funksionit të saj institucional, sipas grafikut të mëposhtëm.

**Takime/Trajnime/Seanca informuese
Viti 2025**



6.3 Fuqizimi i komuniteteve fetare dhe i këshillave Vendore të Sigurisë Publike

QKEDH në koordinim me Hedayah dhe në bashkëpunim me Këshillin Ndërfetar Shqiptarë kanë organizuar konferencën “Shpërndarje mesazhesh për udhëheqësit fetarë dhe të komunitetit në Shqipëri”. Gjithashtu kanë vijuar me një sërë aktiviteteve advokuese dhe trajnimesh për forcimin e rolit të KVSP-ve në bashkitë Kukës, Lezhë, Vlorë dhe Mat, të cilat janë pjesë e Fazës së II-të të projektit “Mbështetja e performancës së Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike në Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”.

6.4 Procesi i Rehabilitimit/Riintegrit/Risocializimit për personat e kthyer nga zonat e konfliktit Siri/Irak

Në lidhje me procesin e rehabilitimit për personat e kthyer nga zonat e konfliktit Siri/Irak, QKEDH vijon të luajë rol të rëndësishëm për zhvillimin e politikave dhe koordinimin në nivel kombëtar, në kuadër të realizimit të iniciativave për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe ndjekjen e proceseve të rehabilitim-riintegrit dhe risocializimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit Siri-Irak.

Në zbatim edhe të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023–2025 janë kryer **4 operacione riatdhesimi** nga shteti shqiptar,

ku ka kthyer **38 shtetas** shqiptarë nga zonat e konfliktit Siri-Irak, konkretisht 1 shtetas në vitin 2019 (i cili nuk ndiqet nga QKEDH), 13 shtetas shqiptarë që u riatdhesuan më datë 27 maj 2022, 19 shtetas shqiptarë të riatdhesuar më datën 1 gusht 2021 dhe 5 shtetas të riatdhesuar në 27 tetor 2020. Përgjatë këtij viti koordinimin dhe monitorimin e punës me ministritë e linjës, agjencitë ligjzbatuese, partnerët kombëtar dhe ndërkombëtarë për të lehtësuar procesin R&R&R në komunitet të 37 shtetasve shqiptarë të riatdhesuar nga zonat e konfliktit Siri-Irak, nga të cilët të riatdhesuar janë të vendosur në territorin e Bashkisë Tiranë dhe 1 rast në Bashkinë Librazhd.

Sigurimi i një angazhimi të qëndrueshëm financiar dhe institucional nga ana e institucioneve shtetërore për procesin e rehabilitimit, ri-integrimit dhe risocializimit të shtetasve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit përbën një detyrim që buron nga parimet kushtetuese, kuadri ligjor në fuqi dhe strategjitë kombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes sociale. Mbështetja e deritanishme e ofruar përmes projekteve të financuara nga donatorë ka pasur karakter plotësues dhe të përkohshëm dhe nuk mund të zëvendësojë përgjegjësinë primare të institucioneve publike për garantimin e shërbimeve bazë, strehimit, mbështetjes psiko-sociale dhe integrimit socio-ekonomik të kësaj kategorie.



VII. QENDRA E PRITJES PËR AZIL

7.1. Azilkërkues të akomoduar


Gjatë vitit 2025, Qendra e Pritjes për Azil ka punuar me profesionalizëm duke trajtuar disa nga çështjet kryesore përkatësisht, statusin ligjor dhe strukturën e institucionit, realizimin e buxhetit për vitin 2025, si dhe aktivitete institucionale. Gjithashtu ka dhënë edhe rekomandime, për mirëfunksionimin dhe organizimin e institucionit, me qëllim përmirësimin e shërbimeve për azilkërkuesit. Realizimi i trajnimeve dhe kualifikimeve të stafit në tërësi, por edhe atyre që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me azilkërkuesit/refugjatët, grupet vulnerabël, ka çuar në rritjen e standardeve lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimeve brenda qendrës.

Qendra e Pritjes për Azil gjatë vitit 2025, ka miratuar strukturën e re të miratuar më Urdhër Kryeministri Nr. 143, datë 29.08.2025, përmes së cilës është rritur efikasiteti dhe përmirësimi i shërbimeve për azilkërkuesit. Në kuadër të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në dokumentin e prioritetëve të Ministrisë së Brendshme për vitin 2025 janë realizuar detyra funksionale, përkatësisht:

- Është bërë analiza dhe programimi për rialokimin e fondeve sipas nevojave emergjente të institucionit dhe ndryshimet në zërat në Regjistrin e Planifikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2025.
- Janë hartuar e miratuar programe pune, raporte mujore dhe raporte të tjera periodike, të cilat pasqyrojnë objektivat kryesore, punën e kryer në përmbushje të tyre, burimet dhe kapacitetet e angazhuara dhe tregues të tjerë për institucionin.
- Është plotësuar e përditësuar dosja personale për çdo punonjës, me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor e administrativ. Përditësohen periodikisht Regjistri i Punëmarrësit dhe ndiqet dinamika e pasurimit të dosjeve me vlerësime periodike, praktika disiplinore, vjetërsi në punë e procedura të tjera që shoqërojnë punonjësin gjatë veprimtarisë së punës.
- Është ndërtuar një procedurë e rregullt administrative e ligjore, sa i përket emërimeve të punonjësve të rinj, praktikave disiplinore dhe atyre të lirimit nga detyra. Për çdo rast, plotësohet sipas standardeve dokumentacioni i duhur dhe ndiqen etapat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Janë marrë masat e duhura për të rritur sigurinë dhe mbrojtjen në punë sipas standardeve ligjore. Pajisjet fikëse të zjarrit janë të mbushura dhe brenda afatit të skadencës, janë të kolauduara dhe janë në gatishmëri për çdo emergjencë të mundshme.


Numri i azilkërkuesve të akomoduar në periudhën Janar-Dhjetor 2025 është **127** persona dhe krahasuar me numrin e azilkërkuesve të akomoduar në periudhën Janar-Dhjetor 2024, i cili rezultonte **97**, ka rritje me **30** azilkërkues të akomoduar më shumë.

Numri i azilkërkuesve të akomoduar



Sipas grafikun e mëposhtëm vihet re se fluski më i madh i azilkërkuesve të akomoduar në qendër ka qenë gjatë muajve shtator, tetor dhe nëntor dhe numri më i ulët i të akomoduar në qendër është shënuar gjatë muajit mars, me asnjë rast.

Numri i azilkërkuesve të akomoduar Janar-Dhjetor 2025 (sipas muajve)



Grafiku i mëposhtëm tregon se gjatë periudhës, Janar-Dhjetor 2025 familjet e akomoduar kanë qenë në total **10** familje me origjinë të ndryshme, sipas grafikut të mëposhtëm.

Numri i familjeve të akomoduar sipas origjinës viti 2025



7.2 Bashkëpunimi me Organizata Jo-fitim Prurëse

Qendra Pritëse për azilkërkues bashkëpunon kryesisht me UNHCR, Qendrën Ura dhe RMSA. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 janë ofruar 395 shërbime shëndetësore, me Qendrën Tek Ura dhe RMSA për shtetasit e akomoduar në QPA është mundësuar realizimi i kursit të gjuhës shqipe një shërbim ky, i cili ndihmon në integrimin e tyre në komunitet si dhe në lehtësimin e komunikimit e socializimin e duhur me shtetasit e tjerë të akomoduar në Qendër.

Për të krijuar një mjedis sa më argëtues dhe relaksues për fëmijët në Qendër ndodhet një dhomë posaçërisht për ta e quajtur “Dhoma e fëmijëve”, gjithashtu dhe Parku i lojrave, Fusha e Futbollit, Volejbollit dhe Basketbollit në ambjentet e jashtme të qendrës. Punojësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilkërkuesve çdo ditë bëjnë të mundur shoqërimin e fëmijëve duke krijuar lojëra argëtuese dhe zhvilluese për ta. Përpos dhomës së fëmijëve qendra ofron gjithashtu edhe sallën e internetit, ku kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare mund të aksesojnë në internet dhe të komunikojnë me familjarët e tyre, si dhe bibliotekën ku mund të lexojnë e të kalojnë kohën në mënyrë produktive.

7.3 Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2025

Është bërë i mundur organizimi i takimeve me partnerët mbi diskutime lidhur me tematikat e azilkërkuesve si dhe forcimin e bashkëpunimit midis tyre, për ofrimin e shërbimeve sipas standarteve ndaj kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe është bërë e mundur marrja e njohurive në lidhje me kompjuterin shfrytëzimin e bibliotekës duke informuar përmes librin dhe mundësia për të qënë më pranë tij. Aktivitete të ndryshme sociale të ndara në kategori (fëmijë dhe të rritur) bazuar në një plan mujor i hartuar nga Sektori i Mbështetjes së Azilkërkuesve dhe disa nga aktivitetet kryesore të realizuara, vijojnë si më poshtë:

- ✓ Në bashkëpunim me RMSA, me rastin e festës së gruas 8-Marsin, u mbajt një sesion informimi se si kjo ditë shërben jo vetëm për bashkimin e grave pa dallim feje, race, kulture, gjuhe dhe prejardhjeje, por edhe për të kujtuar përpjekjet për barazi, paqe dhe drejtësi.

- ✓ Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve (20 Qershor) u organizua aktiviteti nga UNHCR dhe Ministria e Punëve të Brendshme në Europe House, Tiranë dhe Hana Corner Caffé, ku organizuam një ditë ndryshe me gatime tradicionale dhe aktivitete kulturore për të rritur dhe fëmijë.
- ✓ Në ditën Ndërkombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 30.07.2025 u zhvillua një sesion informativ në lidhje me njohjen e këtij fenomen, mbrojtjen dhe raportimin e tij.
- ✓ Në bashkëpunim me UNHCR u organizua një trajnim në lidhje me menaxhimin financiar dhe hapjen e një biznesi, ku azilkërkuesit morën pjesë aktivisht duke fituar njohuri të reja dhe për të ndërtuar mundësi të qëndrueshme dhe një të ardhme të sigurtë.
- ✓ Me rastin e festave të 28-29 Nëntorit organizuam aktivitete të ndryshme për nder të festës së Pavarësisë dhe Çlirimit të Shqipërisë.
- ✓ Në kuadër të festave të fundvitit u bëmë bashkë për një drekë dhe organizuam aktivitete të ndryshme si zbukurimi i pemës së Vitit të Ri dhe shumë aktivitete të tjera me karakter festiv si “Kartolina e Fundvitit”.

7.4 Prioritetet dhe objektivat për vitin 2026

Qendra Pritëse për Azilkërkues do përmirësojë kuotaat financiare për shpenzime ditore për kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare të akomoduar në Qendër në mënyrë që të arrihet përmirësimi i standardeve të shërbimeve të ofruara. Gjithashtu do të forcojë bashkëpunimin me partnerët mbi diskutime lidhur me tematikat e kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare si dhe forcimin e bashkëpunimin midis tyre. Realizimi i trajnimeve dhe kualifikimeve të mëtejshme të stafit që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me azilkërkuesit/refugjatët, mbetet një tjetër objektiv, i cili do të çojë në rritjen e standardeve lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimeve brenda qendrës.




SHTËPIA E PUSHIMIT

Shtëpia e Pushimit gjatë vitit 2025, përshkak të situatës së krijuar pas tërmetit 26.11.2019 ka pasur kapacitetin e shfrytëzimit të dhomave 11.7%. Gjatë kësaj periudhe klientela kryesore ka qenë klientë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, pasi vetëm 15 dhoma kanë qenë në efikasitet. Kështu që për vitin 2025, pavarësisht se u përdorën 11.7 % e kapacitetin akomodues të shfrytëzimit (për shkak të dëmtimeve nga tërmeti), të ardhurat (në raport me kapacitetin e shfrytëzimit) krahasuar me vitin 2023 u **rritën 101.1 %** më shumë.

Gjatë periudhës 2025 të ardhurat krahasuar me 2024 u rritën + 182,813 lekë më shumë (ose 101.1%) sipas strategjisë së ndjekur nga menaxhimi përveç aktivitetit kryesor, për shkak të mungesës së kapacitetit akomodues institucioni është përqendruar në mbledhjen e të ardhurave nga çadrat, parking e biletëhyrje me qëllim futjen në efikasitet të njësisë.

Të ardhura (total) të Shtëpisë së Pushimit viti 2024-2025



Shtëpia e Pushimit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Durrës, edhe për vitin 2025, vijon të ketë po të njëjtin kapacitet shfrytëzimi, ku pavarësisht dëmeve të shkaktuara si pasojë e tërmetit, ka arritur të shfrytëzojë kapacitetet e mjaftueshme për përmirësimin e të ardhurave në total.

Në lidhje me prioritetet dhe objektivat për vitin 2026 është parashikuar që në PBA 2026-2028 si dhe planin strategjik të koordinuar me Ministrinë, të realizohen pikat si më poshtë vijon:

- ✓ **Përmirësimi i drejtimit dhe bashkëpunimit me organet** që janë subjekt i veprimtarisë përkatësisht në përmirësimin e menaxhimit për shërbim efektiv, eficient dhe ekonomik, me qëllim shfrytëzimin e të gjitha kapaciteteve të mundshme.
- ✓ **Zhvillimi i standardeve bashkëkohore**, për të krijuar një shërbim publik funksional me qëllim sigurimin e burimeve të duhura (njerëzore, materiale dhe teknologjike), për të krijuar kuthite të nevojshme për funksionalizimin dhe realizimin e detyrave.
- ✓ **Riparimi i pasojave të pas tërmetit**, ku institucioni ka hartuar një master plan me objektiva të adresuara me qëllim shtimin e kapaciteteve shfrytëzuese, nëpërmjet: riparimit të godinës së hotelit, ku parashikohet të kryhen ndërhyrje me qëllim riparimin konstruktiv dhe arkitektonik

të realizimin e projektit, si dhe ndërtimin e një godine të re, në pruellin e hotelit të shembur, sipas praktikave bashkëkohore duke përfshirë të gjitha shërbimet.



IX. MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI


Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të MZSH-së gjatë vitit 2025, është fokusuar në procesin e konsolidimit të shërbimit, në zbatim të detyrimit ligjor (nenit 10 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i ndryshuar. Gjithashtu ka qenë e fokusuar në monitorimin e aspektit të veprimtarisë për parandalimin i zjarreve dhe situatave emergjente, minimizimin e pasojave në raste zjarresh, mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve, duke përmirësuar vazhdimisht parametrat e sigurisë publike. Përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve operacionale, ka vijuar kryesisht në disiplinimin e aspektit procedural dhe përmirësimin e instrumenteve për parandalimin dhe inspektimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Objektivat dhe përgjegjësitë kryesore të drejtorisë janë:

- **hartimi i projekt-politikave** për parandalimin, inspektimin, menaxhimin dhe ndërhyrjen operacionale në raste zjarri dhe fatkeqësish natyrore apo njerëzore;
- **koordinimi i strukturave** të shërbimit zjarrfikës në nivel vendor, në rastet e zjarreve masive apo situatave të tjera, për operacione komplekse shpëtimi;
- **hartimi dhe zbatimi i politikave** dhe standardeve teknike për mbrojtjen nga zjarri;
- **bashkëpunimi dhe koordinimi** i veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së me strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, të Mbrojtjes Civile, Shërbimit të Urgjencës Mjekësore dhe të institucioneve të tjera qendrore, për rritjen e sigurisë publike;
- **mbledhja e indikatorëve statistikorë** për aktivitetin dhe veprimtarinë e shërbimit vendor të MZSH-së.
- **kontrolli dhe zbatimi i standardeve** në fushën e sigurisë nga zjarri, në kuadër të zbatimit të politikave të miratuara për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

9.1 Praktikë dhe procedurat e ndjekura për vitin 2025


Praktikat dhe procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të MZSH-së, shënojnë numrin me të lartë në ripërtëritje e certifikatës së sigurisë nga zjarri me **387 praktika** (reflektuar në grafikun e mëposhtëm), të cilat janë kryer në zbatim të procedurave me qëllim garantimin e sigurisë.

Praktika dhe procedura të realizuara viti 2025




9.2 Zjarre, inspektime dhe ndërhyrje shpëtimi

Kjo analizë vjetore synon të paraqesë një vlerësim të përgjithshëm dhe krahasues të veprimtarisë zjarrfikëse dhe inspektuese, duke analizuar treguesit kryesorë operacionalë, tendencat e rrezikut dhe efektivitetin e masave parandaluese. Në vitin 2025 është evidentuar një rritje e ndjeshme e ndërhyrjeve, duke reflektuar një ngarkesë operative më të lartë për strukturat zjarrfikëse. Ky trend tregon zgjerim të rolit të shërbimit në menaxhimin e emergjencave dhe kërkon rishikim të kapaciteteve njerëzore dhe logjistike. Nga ana tjetër rritja e numrit të inspektimeve në vitin 2025 me **806 inspektime** më shumë krahasuar me vitin 2024, përfaqëson një zhvillim pozitiv në aspektin e parandalimit, reflektuar sipas grafikut të mëposhtëm.



Megjithatë, krahasimi me rritjen e zjarreve tregon se ndikimi parandalues i inspektimeve mbetet i kufizuar dhe kërkon riorientim drejt sektorëve me risk të lartë. Gjatë vitit 2025 ka pasur **10 532** zjarre në total dhe numri më i lartë është shënuar në muajin korrik 2025 me **2097** raste dhe numri më i ulët në muajin nëntor 2025 me **350** raste.

Numri i zjarreve viti 2025



Krahasuar me vitin 2024 ku ka pasur 10 226 raste zjarri, në vitin 2025 janë shënuar 306 raste zjarri më shumë. Në vitin 2024 ka pasur një numër total sipërfaqesh të djegura më shumë, por në vitin 2025 ka pasur një sezon zjarri intensiv dhe më të gjatë, me rritje të shpejtësisë së djegies dhe më shumë ndërhyrje zjarrëfikëse, veçanërisht në muajt e verës, duke reflektuar kështu edhe ndikimin klimatik (valë të nxehtësisë dhe thatësira).

Numri i zjarreve Krahasim viti 2024 - 2025




Gjatë vitit 2025 ka pasur një rritje të ndjeshme të ndërhyrjeve, duke reflektuar një ngarkesë operative më të lartë për strukturat e varësisë. Ky trend tregon zgjerimin e rolit të shërbimit dhe menaxhimit të emergjencave me qëllim përmirësimin e kapaciteteve logjistike dhe njerëzore. Gjatë vitit 2025 ka pasur **1871 raste** ndërhyrje për shpëtim. Ndërhyrjet për shpëtim kanë shënuar nivelin më të lartë, në muajin dhjetor me **296 raste** dhe numri më i ulët në muajin shkurt me **71 raste**.



Përmirësimi i aktivitetit parandalues, niveli i rriskut dhe incidentet kanë shënuar rritje, duke kërkuar orientim strategjik të masave parandaluese. Gjatë 2025 janë shënuar **4696 inspektime** dhe rritja e numrit të inspektimeve ka ndikuar në forcimin e rolit të parandalimit, si shtyllë kryesore e menaxhimit të rrezikut nga zjarret.

**Zjarre, ndërhyrje shpëtimi dhe inspektime
viti 2025**



9.3 Bashkëpunime projekte dhe aktivitete të realizuara përgjatë vitit 2025

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të MZSH-së, ka ndjekur projektet dhe ka realizuar aktivitete përgjatë vitit 2025, duke rritur kështu performancën dhe shërbimin. Disa nga projektet dhe aktivitetet kryesore janë si më poshtë vijon:

- Projekti UNDP “*Forcimi i kapaciteteve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit*” 2021 – 2025 , shërbimi zjarrfikës ka qenë përfitues në 10 bashki, përkatësisht:
 - **169 uniforma zjarrfikëse** PPE për bashkitë Fier, Kamëz, Krujë, Kurbin, Kavaja, Pogradec, Lezhë, Shijak;
 - **pajisje zjarrfikëse** (3 automjete zjarrfikëse dhe 3 kontejnerë me të gjitha pajisjet e kërkim shpëtimit për bashkitë Durrës, Lezhë, Fier);
 - ndërtimi i **2 stacioneve** zjarrfikës të rinj ne Fier dhe Pogradec;
 - trajnimi i **356 punonjësve** të shërbimit MZSH-së.

- Projekti i Bankës Botërore “Mbështetje për DPMZSH në kuadrin e Asistencës Teknike TAFF për parandalimin e rreziqeve ndaj katastrofave”, janë realizuar misione në terren me ekipin e konsulencës, i cili përfshinte vizita dhe shkëmbim informacioni me shumë institucione.
- Projekti IPA CARE 2023-2027 “Capacity for Risk Management of Earthquakes and Health Emergencies”, në bashkëpunim me AKMC, kemi qenë pjesëmarrës në disa takime ndërinstytucionale.
- Projekti “Për Menaxhimin e Integruar të Riskut nga Përmbytjet në Basenin e Drinit” (Projekti Drini FRM).
- Workshopin “Rruga e mësimit për përgatitjen nga UNDP për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi”.

Drejtorja ka marrë pjesë në Komitetin Ndërminterial të transportit të mallrave të rrezikshme, mobilizues për rajonin, në kuadër të projektit TAIEK-it, si përfaqësues nga shërbimi zjarrfikës në rolin e anëtarit në këtë komitet. Gjithashtu, është bashkëpunuar me AKMC dhe ODC (Zyra e Bashkëpunimit të Mbrojtjes Amerikane), për evidentimin, vlerësimin dhe investimin në infrastrukturën dhe kapacitetet e shërbimeve zjarrfikëse vendore. Është rënë dakord për investime për ndërtimin e katër stacione zjarrfikëse, përkatësisht: Prrenjas, Mat, Patos dhe Mirditë.

Bashkëpunim i vazhdueshëm me AKMC-në për pjesëmarrjen e DPMZSH-së në aktivitetet që ka zhvilluar kjo agjenci, për rritjen e kapaciteteve parandaluese dhe reaguese, në menaxhimin e situatave emergjente dhe ato të kërkim-shpëtimit.

9.4 Trajnime të punonjësve sipas Plan-Kalendarit 2025

Planifikimet për trajnimin e punonjësve të zjarrfikësve, ka vijuar me intensitet dhe përgjegjshmëri nga strukturat e DPMZSH, të cilat kanë realizuar trajnimin e **155 punonjësve** për marrjen e gradës, përmes kurseve të realizuara në Akademinë e Sigurisë, reflektuar sipas grafikut të mëposhtëm.

Numri i punonjësve viti 2025



Krahas trajnimeve të realizuara për marrjen e gradës, është hartuar dhe miratuar programi vjetor i stërvitjes, i cili është dërguar në çdo bashki së bashku me udhëzimet përkatëse për zbatimin e tij. Nga drejtoria ka pasur kontrolle të vazhdueshme për zbatimin e këtij plani, si dhe është kryer testimi vjetor i punonjësve të nivelit bazë në bashkitë Gjirokastrë dhe Libohovë.

Strukturat e Shërbimit Zjarrfikës konsiderohen jetike për garantimin e sigurisë publike, mbrojtjen e jetës njerëzore, pasuritë dhe mjedisin. Gjithashtu ky shërbim do të vijojë përforcimin e kapaciteteve njerëzore dhe reaguese për përballimin e emergjencave.